



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-31546

Dt. 03.06.2025

Prizren

Me kërkesën e Nazim Kaçamaku, Vedat Kaçamaku, Ardian Kuksi, Gjeni Kuksi – investitor SAVE Construction Sh.P.K. Prishtinë, me të cilën ka kërkuar leje për ndërtimin e objektit “objekt banimi kolektiv dhe afarizem” i cili gjendet në rrugën “Mbreti Pleurat” nr./, në ngastrën katastrale numër P-718130068-06930-1 dhe P-718130068-06919-0, Z.K.Prizren, në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5.1, 1.7, 1.16, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.2 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1, e lidhur me nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim numër 04/L-110 si dhe nenit 3. paragrafi 1 pika 1.6, 1.9, 1.12, 1.24, 1.25 dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor numër 04/L-174 të datës 31. 07. 2013, si dhe konform nenit 33 paragrafi 1. Pika 19 të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale numër 01/11-46063 të datës 28. 03. 2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit numër 01/011-41141 të datës 10. 04. 2014, dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 numër 001-011-48192 datës 31. 03. 2022, e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27, 44, 46, 47, 48 si dhe nenit 125, 127 të L. P. P. A. numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 merr këtë:

## V E N D I M (për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<b>Nazim Kaçamaku, Vedat Kaçamaku, Ardian Kuksi, Gjeni Kuksi – investitor SAVE Construction Sh.P.K. Prishtinë</b>		
Adresa:	<b>Prizren</b>		
Telefoni:	///	Emaili:	///

Emri i projektit	<b>“objektit – banim kolektiv dhe afarizem”</b>		
Emri i projektuesit	<b>Byro Projektuese “Master Projekt” SHPK</b>		
Adresa:	<b>Prizren</b>		
Telefoni:	//	Emaili:	

Me këtë Vendim, aplikuesit për Leje Ndërtimore Nazim Kaçamaku, Vedat Kaçamaku, Ardian Kuksi, Gjeni Kuksi – investitor SAVE Construction Sh.P.K. Prishtinë i lejohet ndërtimi i

**objektit “banim kolektiv dhe afarizem” me etazhitet B+P+6+PH në rrugën “Mbreti Pleurat” nr./, zona Kadastrale Prizren.**

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa	Rruga “ <b>Mbreti Pleurat</b> ” nr./	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar për ndërtim – <b>Objekt “banim kolektiv dhe afarizem”, B+P+6+PH.</b></p> <p>Objekti – ndërtimi i objektit në parcelën nr:  <b><u>P-718130068-06930-1 dhe P-718130068-06919-0,</u></b>  <u>Z.K.Prizren.</u></p> <p>me sipërfaqe <b>S=10787m<sup>2</sup></b> me dimensione sipas kopjes së planit.</p> <p>Sipërfaqja e bodrumit është:  - Brutto S= 7791.68m<sup>2</sup>  - Netto S= /m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e përdhesës është:  - Brutto S= 5347.97m<sup>2</sup>  - Netto S= 2765.04m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të I-rë është:  - Brutto S= 4553.67m<sup>2</sup>  - Netto S= 3979311m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të II-të është:  - Brutto S= 45363.57m<sup>2</sup>  - Netto S= 3984.31m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të III-të është:  - Brutto S= 4536.57m<sup>2</sup>  - Netto S= 3984.31m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të IV-të është:  - Brutto S= 4261.30m<sup>2</sup>  - Netto S= 3713.60m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të V-të është:  - Brutto S= 3996.30m<sup>2</sup>  - Netto S= 3446.51m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të VI-të është:  - Brutto S= 3756.00m<sup>2</sup>  - Netto S= 3264.91m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqja e Katit të PH-së është:  - Brutto S= 2013.20m<sup>2</sup>  - Netto S= 1743.80m<sup>2</sup></p> <p>Sipërfaqet totale të objektit jane  - Brutto S= 40847.26m<sup>2</sup>  - Netto S= 26881.49m<sup>2</sup></p>	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore në shumën prej **65,304.56€ - kësti i I-rë (30% e sipërfaqes totale të objektit) – sipas Marreveshjes të datës 21.05.2025.**
- Parallogaria e vleres se objektit sipas këtij dokumentacioni teknik ehste ne shumen prej **14,214,232.79€.**

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindërtim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndertimeve te propozuera: Kategoria I <input type="checkbox"/> Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar: "banim kolektiv dhe afarizem", B+P+6+PH

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Nazim Kaçamaku, Vedat Kaçamaku, Ardian Kuksi, Gjeni Kuksi – investitor SAVE Construction Sh.P.K. Prishtinë** i lejohet ndërtimi i – **Objektit "banim kolektiv me afarizem" etazhitet B+P+6+PH.**

### Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
  - Informata mbi Lejen Ndërtimore
  - Informatat mbi projektuesin
  - Informata mbi kontraktuesin
  - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
  - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - Një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - Një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
  - Projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit; x
  - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
  - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;

- Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuatë dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
  - o Ndrysimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin kdhe rregulloret teknike në fuqi;
  - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## A r s y e t i m

Aplikuesi **Nazim Kaçamaku, Vedat Kaçamaku, Ardian Kuksi, Gjeni Kuksi – investitor SAVE Construction Sh.P.K. Prishtinë** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e **Objektit “banim kolektiv me afarizem”**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimore të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- **Kushtet ndërtimore 04-353/01-132125 të datës 14.10.2024.**
- **Pëlqimi nga “KEDS-i”.**
- **Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.**
- **Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.**
- **Pëlqimi nga Ekoregjioni.**
- **Pëlqimi nga Kompania Rajonale e Ujitjes – Dugagjini.**
- **Aktvendimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë.**
- **Pëlqimi nga DSHP – Sektori i Komunikacionit.**
- **Leja Mjedisore Komunale**
- **Projekti kryesor.**


**Udhëzimi juridik:** pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë s Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR**

**Nr. 04-351/02-31546, Dt. 03.06.2025**

**Hartoi:**

**Bashkëpunëtorët profesional:**

  
**Shpresa Osmanollaj Krap, inxh. dip.ark.**

**Drejtori:**

  
  
**Pranverim Berisha, jurist.**